



Eksperimenti komunal për punësim fillon në vitin 2021

Synimi i Shërbimeve të Helsinkit për punësim është të përmirëson në mënyrë edhe më efikase punësimin dhe trajnimin/shkollimin e të papunësuarve që kërkojnë punë si dhe të sjellin zgjidhje të reja për gjetjen e fuqisë punëtore të kualifikuar.

Prezantim i shkurtër

Eksperimenti komunal për punësim i sjell Shërbimeve të Helsinkit për punësim afër 50 000 punonjës të Helsinkit nga Enti i punësimit. Ky ndryshim hyn në fuqi me 1.3.2021. Me këtë ndryshim nga Enti i punësimit i transferohen qytetit edhe rreth 250 punonjës dhe lokale nga Itäkeskus dhe Pasila.

Çfarë eksperimenti komunal për punësim?

Çka është eksperimenti komunal për punësim?

Eksperimenti komunal për punësim është projekt mbarëkombëtar 2,5 vjeçar, në të cilin një pjesë e shërbimeve ligjore të punësimit të Entit të punësimit i transferohet komunës që ti organizon. Në eksperimentin komunal marrin pjesë 125 komuna dhe 26 zona eksperimentale që formojnë ato. Helsinki vet është një zonë eksperimentale. Në rajonin e kryeqytetit përveç Helsinkit gjinden edhe zonat eksperimentale Espoo dhe Vantaa-Kerava.

Pse organizohet ky eksperiment?

Qëllimi i eksperimentit komunal është të përmirëson ndikueshmërinë e shërbimeve të punësimit dhe zgjedhjet e shërbimeve për kërkuesit e punës dhe përvojat e klientëve. Qëllim është që kjo të bëhet p.sh. duke e bërë më të rrjedhshëm arritjen deri te shërbimet që ofrojnë komunat. Ndikueshmërinë tentojnë ta përmirësojnë duke bashkuar stafin, financimin dhe lokalet e komunës dhe shtetit në trajtimin e punësimit.



A më përket kjo mua?

Eksperimenti komunal dhe transferi i shërbimeve qytetit Helsinki mundsisht të përket ty nëse jeton në Helsinki, je pa punë që kërkon punë apo merr pjesë në shërbimet e punësimit dhe për ty vlenë ndonjë nga këto:

- je nën 30-vjeçar ose
- je i gjuhës tjetër. Gjuhë amtare nuk e ke finlandishten ose
- nuk ke të drejtë për mëditjet e bazuara në të ardhurat. Për shembull, nga Kela merr mëditjet e tregut të punës, asistencë elementare apo mëditjet e pushimit mjekësor.

Do të merrni personalisht edhe një letër nga Enti i punësimit si dhe lajmërimin në shërbimin Oma asiointi nëse transferoheni/kaloni në eksperimentin komunal.

Ndikimi i ndryshimit në mua?

Kur fillon eksperimenti?

Eksperimenti komunal fillon nga 1.3.2021 – 30.6.2023.

A ndikon ky ndryshim në asistencat time të papunësisë?

Ndryshimi nuk ndikon në mëditjet tua të papunësisë.

Me fillimin e eksperimentit komunal mbetet në fuqi deklarata e Entit të punësimit për politikën e punës paguesit të asistencave të papunësisë (KELA ose arka e papunësisë) kur bëhesh klient i Shërbimeve të Helsinkit për punësim. Eksperimenti komunal nuk ndikon në shqyrtimin e asistencave tua të papunësisë në Kela apo në arkën e papunësisë. Ndryshimi nuk duhet të ndikon shumë në afatin e aplikimit tënd dhe të dhënjes së asistencës të papunësisë nga Kela apo nga arka e papunësisë.

Në fillim të ndryshimit shërbimet e qytetit mund të jenë të ngarkuara me bërjen e vendimeve të reja. Nëse ke mundësi disi të ndikosh, mos bën veprime që kërkojnë vendime dhe aprovime kur të afrohet koha e transferit.

Çfarë duhet të bëj unë për shkak të këtij ndryshimi?

Si kërkues i punës ti nuk ke nevojë të bësh asgjë për shkak të këtij ndryshimi.

Planet e mëparshme të punësimit ose planet tua tjera janë akoma në fuqi. Shërbimet e punësimit në zonën tënde të eksperimentit komunal, për banorët e Helsinkit pra **Shërbimet e Helsinkit për punësim**



Työllisyyspalvelut Syssestättningstjänster Employment services

janë në kontakt me secilin klient që kërkon punë menjëherë po sa të zgjidhet eksperti përgjegjës i ri. Gjatë zgjedhjes të dërgojmë informacione tjera për shërbimet klientëve të Shërbimeve të Helsinkit për punësim.

A do ta kem punonjës in përgjegjës edhe në të ardhmen? A ndrohet eksperti im?

Edhe në të ardhmen secili klient që kërkon punë do ta ketë ekspertin e vet përgjegjës.

Eksperti yt përgjegjës mund të ndrohet kur shërbimet i kalohen qytetit. Eksperti i ri caktohet sa më shpejtë pas transferit. Për ekspertin tënd përgjegjës do të informohesh me letër dhe në shërbimet Oma asiointi po sa të caktohet. Do të informojnë edhe në rast se eksperti yt përgjegjës nuk ndrohet.

Për ekspertin tënd përgjegjës do të informohesh nga ana e Shërbimeve të Helsinkit për punësim.

A i kufizon disi veprimet e mia?

Për shkak të eksperimentit komunal në të ardhmen do të veprosh vetëm te eksperti yt zyrtar në shërbimet e punësimit të komunës tënde.

Për shembull: Banori i Helsinki banon më afër Entit të punësimit Vantaa se sa Entit të punësimit Helsinki dhe ky përpara ka vepruar aty. Atë nuk mund ta shërbejnë më në Entin e punësimit Vantaa gjatë eksperimentit komunal.

Kërkuesit e punës që janë klient të eksperimentit komunal mund të shërbehen vetëm në shërbimet e punësimit të komunës së tyre.

A ndryshojnë për mua shërbimet?

Si klient i eksperimentit komunal ke të njejtat shërbime si ato më parë nga Enti i punësimit. Për shërbimet e qytetit Helsinki mund të ketë ndryshime të vogëla pasi që numri i klientëve ndryshon dukshëm

Gjatë kohës së eksperimentit komunal për punësim do të zhvillojmë shërbime dhe zgjidhje të reja për trajtimin e punësimit si dhe do të përforcojmë bashkëpunimin p.sh. me shërbimet sociale-shëndetsore dhe shërbimet e arsimit dhe shkollimit për të përmirësuar punësimin. Pra, mundësitë e shërbimeve tua do të zgjerohen gjatë kohës së eksperimentit komunal.

Jamë klient i TYP (ShPP apo shërbimeve për punësim). A ndryshojnë shërbimet e mia?

Shërbimet ShPP do të keni edhe në të ardhmen, por në eksperimentin komunal organizohet në mënyrë tjetër. Kjo do të thotë se mund të ndryshojnë punkti i veprimit ose eksperti përgjegjës për ty.

Ligji mbi shërbimeve të shumëllojshme të përbashkëta që përmirësojnë punësimin nuk ndryshon dhe gjatë kohës së eksperimentit komunal ato shërbime do ti quajmë *shërbime rehabilituese për këthim në punë*.



Työllisyyspalvelut Sysselsättningstjänster Employment services

Në çfarë gjuhe është shërbimi?

Shërbimet gjithmonë ipen në gjuhën finlandishte dhe suedishte. Zakonisht i merr shërbimet pa ndonjë organizim të veçantë edhe në gjuhën anglishte pa rezervuar kohën.

Shërbimet e përkthyesve si ndihmë gjatë takimit organizohen për ata që kanë nevojë, njejt si në shërbimet e Entit të punësimit.

Ku mund ti marr shërbimet?

Ku mund të marr shërbime nëse transferohem si klient te Shërbimet e Helsinkit për punësim? Si në fazën e transferimit?

Në rrjet mund të përdorë shërbimet në faqet [Oma asiointi](#) të cilat i mirëmbanë Enti i punësimit si përpara.

Përmes telefonit mund të merr shërbime të punësimit pa ndërprerje në numrin për klientët që e mirëmbanë Enrti i punësimit: **0295 025 500** (hë-pr nga ora 9.00–16.15)

Nga shërbimet telefonike të ndihmojnë për veprimet në takim, për përdorimin e shërbimeve Oma asiointi në rrjet dhe për gjërat lidhur me punësim. Sipas nevojës të drejtojnë në shërbime tjera që të përshtatshme.

Shërbime në hollin tonë merr me nisjen e eksperimentit komunal nga fillimi i vitit 2021 në këto adresa:

- Asiakkaankatu 3 në Itäkeskus
- Ratapihantie 7 në Pasila
- për nën 30-vjeçarët Ohjaamo në adresën Fredrikinkatu 48 në Kampi.

Shërbime poashtu ipen edhe në kohë të rezervuar në adresat Viipurinkatu 2 dhe Runeberginkatu 5.

Shërbimet sy në sy për klientët zbatohen aq sa lejon situata e koronës.

Në Helsinki-info merr shërbime në formë të këshillave nga shërbimet e Helsinkit, pra për shembull informacione për orarin e punës apo të dhëna themelore tjera.

Helsinki-info numri i telefonit: **09 310 11 111** (hë-enj nga ora 9–16 dhe pr nga ora 10–15)

Helsinki-info [chatti](#) (hë-enj nga ora 9–16 dhe pr nga ora 10–15)



Työllisyyspalvelut Syssestättningstjänster Employment services

Ku të marr informacione tjera?

Informacione tjera mund të shiqoni në këto faqe:

[Faqet e Eksperimentit komunal për punësim hel.fi](#)

[Faqet e Ministrisë së punësimit dhe ekonomisë për Ekperimentin komunal për punësim](#)

[Shërbimet e Helsinkit për punësim twitter](#)

Përcjellni poashtu përditësimin e kësaj faqe dhe mediat si p.sh. shtypin dhe lajmet në television.

Poashtu mund të dërgoni mendimet e juaja me e-mail ose pyetje të natyrës së përgjithshme Shërbimeve të Helsinkit për punësim në adresën tyollisyyspalvelut@hel.fi.

Vëni re! Përmes postës elektronike klientëve nuk mund të iu ofrojmë shërbime personale që kërkojnë identifikim. Me postë elektronike mos na dërgoni informacione të ndjeshme si për shembull për gjendjen e juaj shëndetsore apo jetësore ose të dhënat personale të juaja. Mund të përgjigjemi në postën elektronike vetëm në pyetjet e natyrës së përgjithshme dhe ti përcjellim mendimet e juaja më tutje.

Ku të lajmërohem si i papunë?

Edhe në të ardhmen lajmërohesh si i papunë përmes shërbimeve të Entit të punësimit. Mund të lajmërohesh si i papunë në shërbimet Oma asiointi ose në punktun e Entit të punësimit. Enti i punësimit i drejton klientët e ekperimentit komunal te shërbimet e punësimit të komunave të kërkuessve të punës.